Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Në këtë kapitull do të mësojmë të zgjidhim ekuacione. Mos u shqetësoni – me ekuacionet do të merreni për vite me radhë. *Ekuacioni* është një fjali numerike që përmban një shenjë barazie, e cila do të thotë se dy shprehjet kanë të njëjtën vlerë. Ja tre shembuj:

$$9 + 6 = 15 \qquad 9 + 6 = 5 \times 3 \qquad 7 + 8 = 18 - 3$$

Megjithatë, në këtë kapitull, do të studjoni ekuacione me ndryshore (madhësi të ndryshueshme), të tilla si $3 \times n = 18$.

Do të njiheni me një *mënyrë* të quajtur mënyra e kundërt, e cila përdoret për të zgjidhur ekuacione. Për shembull, hidhini një sy ekuacionit $4 \cdot n + 5 = t$. Për të gjetur një rezultat (t) me këtë ekuacion, nisuni nga vlera hyrëse (n), shumëzojeni me 4, dhe shtoni 5. Këto hapa ilustrohen me diagramin rrjedhës të mëposhtëm:



Ja diagrami për një vlerë hyrëse 3:



Nëse ju është dhënë një rezultat 21, mund t'a përdorni diagramin rrjedhës për t'u kthyer prapa dhe për të gjetur vlerën hyrëse 4.

Do të vini re se disa ekuacione nuk mund të zgjidhen me mënyrën e kundërt. Për raste të tilla, do t'ju duhet mënyra *hamendje-kontroll-përmirësim.*

Fjalor Ja një listë termash të rinj, që lidhen me zgjidhjen e ekuacioneve.

mënyra e kundërt	**mosbarazim**	**ekuacion**
diagram rrjedhës	**hamendje-kontroll-përmirësim**	**zgjidhje**
fjali e hapur		

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Nxiteni nxënësin t'ju tregojë mënyra për zgjidhjen e ekuacioneve. Mund edhe të luani një lojë gjatë së cilës çdonjëri prej jush të shkruajë një ekuacion në një copë letre, pastaj t'i shkëmbeni copat e letrave dhe të zgjidhni ekuacionet e njëri-tjetrit. Pasi ta keni gjetur zgjidhjen, diskutoni për të.